



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit



Të nderuar lexues,

Këtë vit, për herë të parë Ministria e Financave ka hartuar një Plan të Integruar ku përfshihen sfidat e saj më të rëndësishme për vitin që kemi përpara.

Viti 2007 do të shënoje një hap të rëndësishëm pozitiv në zhvillimin ekonomik e financiar të vendit. Duke filluar me krijimin e një klime të stabilitetit makroekonomik e financiar, si një faktor themelor në zhvillimin e sektorit privat, ne do të punojmë që për vitin 2007 ritmi i rritjes ekonomike të kthehet në 6%, e mbështetur kjo në një rritje të vazhdueshme të eksporteve, përshpejtim të ritmit të rritjes së sektorit të shërbimeve, e njëkohësisht duke i kushtuar një vëmendje të vecantë investimeve publike, kryesisht në sektorin e transportit rrugor.

Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së administratave tona të mbledhjes së të ardhurave do të konsolidojë akoma më tepër sistemin tonë fiskal dhe do të rrisë kursimet publike, sidomos duke ulur në mënyrë të konsiderueshme koston e interesave të huamarrjes, nëpërmjet një menaxhimi më të mirë të borxhit publik.

Gjithashtu, gjatë vitit 2007 ne kemi si objektiv të arrijmë një rritje në kursimet private, kryesisht atyre të biznesit, si rezultat i reformave të forta strukturore dhe rritjes së nivelit të të ardhurave.

Objektivi ynë prioritar mbetet zbatimi i suksesshem i Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit me Bashkimin Europian dhe bashkëpunetori në këtë rrugë do të vazhdojmë të kemi institucionet financiare ndërkombëtare, në mënyrë të vecantë Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Duke ju uruar lexim të këndshëm, ju ftoj të dërgoni komentet tuaja të cilat do të jenë të mirëpritura dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e punës sonë.

Sinqerisht,

Sinqerisht,
Ridvan Bode
Ministër i Financave



Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Qëllimi i politikës dhe programet buxhetore të Ministrisë	4
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	7
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	12
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	13
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Programin e Qeverisë	14
Aneks 3	Rezultate që lidhen me Integrimin Europian	17
Aneks 4	Rezultate që lidhen me anëtarësimin në NATO	19
Aneks 5	Investimet publike	20
Aneks 6	Projekte të ndihmës së huaj	21

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Financave është këshilluesi kryesor i Qeverisë dhe zbatuesi i politikave në lidhje me mobilizimin e burimeve dhe menaxhimin e fondeve publike. Ministria e Financave ka gjithashtu një rol të përgjithshëm këshillues, në interes të Qeverisë, për promovimin e efikasitetit, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik, dhe në ato institucione financiare në të cilat Qeveria merr pjesë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka si mision të saj mbledhjen me efikasitet dhe efektivitet të të ardhurave tatimore, duke i ofruar taksapaguesve një shërbim cilësor dhe duke i ndihmuar ata të shlyejnë detyrimet ndaj shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka si mision të saj sigurinë e tregjeve dhe të popullatës (mbrojtja e kufijve kombëtare, mbrojtja e konsumatorëve, mbrojtja e mjedisit) nëpërmjet mbikqyrjes efikente të doganave dhe bashkëpunimit brënda dhe jashtë vendit, mbledhjen e të ardhurave nga taksat që administrohen nga Dogana, dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e biznesit nëpërmjet aplikimit të metodave moderne të punës dhe krijimit të "Doganave elektronike".

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e financave

Strategjia sektoriale e financave, e udhehequr nga Ministria e Financave, mbulon katër funksione bazë të qeverisë qendrore: politikën fiskale, administrimin e të ardhurave, menaxhimin e buxhetit dhe të shpenzimeve publike dhe menaxhimin financiar. Kjo strategji mbulon, përveç institucionit të Ministrisë së Financave, edhe Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave.

Strategjia sektoriale ka përfunduar procesin e formulimit dhe është në fazën e konsultimit me Grupin Këshillimor Sektorial dhe Grupin e Punës së Asistencës së Huaj për Menaxhimin e Financave Publike. Ministria e Financave do të dorëzojë një strategji të tipit "e plotë". Ajo pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave në prill 2007.

Strategjia ndërsektoriale e sigurimeve shoqërore

Strategjia ndërsektoriale e sigurimeve shoqërore udhëhiqet nga Ministria e Financave. Ajo është ende duke u përgatitur dhe pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave në shtator 2007.

3 Qëllimi i politikës dhe programet buxhetore të Ministrisë

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të shpenzimeve publike, nëpërmjet institucionalizimit të PBA-së dhe dispozitave të ligjit të ri Organik të Buxhetit, duke vënë theksin në fusha si: cikli i buxhetit, procesi i përgatitjes dhe ekzekutimit të buxhetit, harmonizimi i sistemeve të pagesave, dhe në përgjithësi përmirësimi i kompetencave organizative në Ministrinë e Financave dhe ministritë e Linjës, për të menazhuar strategjikisht burimet
- Implementimi me sukses i buxhetimit me bazë performance në të gjitha institucionet buxhetore deri në vitin 2012 si dhe harmonizimi i gjithë legjislacionit të sistemit buxhetor me standartet e njohura të BE-së dhe ndërkombëtare deri në vitin 2010.
- Përmirësimi i planifikimit dhe zbatimit të investimeve publike, nëpërmjet forcimit të sistemit të përzgjedhjes, planifikimit, buxhetimit dhe menaxhimit të projekteve të investimit publik.
- Paraqitja e parashikimeve makroekonomike e fiskale sa më realiste, përgatitja e vlerësimeve dhe risqeve të zhvillimit ekonomik si dhe propozimi i ndryshimeve në politikën e taksave në përputhje me qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik e social, duke mbajtur parasysh objektivat për mbajtjen e ritmeve relativisht të larta të rritjes ekonomike (6-8% cdo vit), mbajtjen e inflacionit në kufijt të përshtatshëm, ndjekjen e një kursi fleksibël këmbimi, uljen e deficitit buxhetor nëpërmjet rritjes së të ardhurave fiskale dhe menaxhimit me efektivitet të shpenzimeve publike, uljen e borxhit publik etj.
- Maksimizimi i mbledhjes së të ardhurave tatimore (ku përfshihen dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore) brenda kuadrit të legjislacionit tatimor.
- Shpërndarja e bazës së taksave në mënyrë më të barabartë dhe më pak deformuese; rritja e nivelit të shlyerjes vullnetare të detyrimeve tatimore dhe rritja e formalizimit të punësimit
- Zhvillimi i një sistemi taksash nxitës për zhvillimin ekonomik dhe atë të biznesit
- Të ndihmojë tatimpaguesit për të paguar detyrimet e tyre tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, dhe të sigurojë që të ardhurat nga keto detyrime të shkojnë për llogari të buxhetit të shtetit, duke i ofruar tatimpaguesve një sistem pagese eficient dhe efektiv.
- Unifikimi i legjislacionit Doganor me atë të vendeve të BE
- Rritja e cilësisë së shërbimit në doganë duke shkurtuar në vazhdimësi kohën e përpunimit të deklaratave doganore të mjeteve dhe mallrave
- Vazhdimi i informatizimit të procedurave doganore në planin horizontal dhe vertikal.
- Implementimi dhe zbatimi i modulit të analizës së riskut në degët doganore me fluks të lartë dhe të mesëm
- Trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personelit doganor në kuadrin e përafrimit dhe implementimit të teknikave doganore në përputhje me ato të BE.

- Forcimi i bashkëpunimit të ndërsjellë administrativ me vendet që kanë nënshkruar MSA si dhe me vendet anëtare të BE me qëllim unifikimin e praktikave doganore dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e luftës kundër shkeljeve doganore.
- Sigurimi i fondeve të nevojshme të huamarrjes duke patur në konsideratë koston dhe riskun e tij në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë
- Krijimi i një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të kontrollit të brëndshëm financiar publik në Shqipëri nëpërmjet një shërbim të pavarur të funksionit të auditimit të brëndshëm dhe një shërbim qendror në Ministrinë e Financave për zhvillimin dhe zbatimin e një metodologjie të harmonizuar dhe një cilesie të standartizuar të sistemit të kontrollit të manaxhimit financiar deri në vitin 2012.
- Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Financave dhe niveleve të tjera të vendimarrjes. Afrimi i kushteve të punës me standartet e BE. Përmirësimi i kushteve të godinës së Ministrisë, përmirësimi i shërbimeve të IT. Krijimi i një sistemi modern të pagave dhe kontabilitetit brënda vitit 2009.
- Hartimi dhe plotësimi i legjislacionit përkatës lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, me një ligj të ri dhe aktet nënligjore që i korrespondojnë atij, si edhe ndërtimi i infrastrukturës së teknologjisë dhe informacionit dhe rritja e performancës së burimeve njerëzore.

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Aparatit të Ministrisë së Financave, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e politikave që bëjnë të mundur përmbushjen e standarteve të vendosura nga BE, si dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të Ministrisë.

3.2 EKZEKUTIMI I PAGESAVE TE NDRYSHME

Politika e këtij programi konsiston në pagesën kryerjen e pagesave të detyrimeve të ndryshme të qeverisë ndaj qytetarëve.

3.3 MBËSHTETJE DHE PJESEMARRJE NE INSTITUCIONET FINANCIARE

Politika e këtij programi konsiston në mbështetjen financiare të institucioneve financiare ku qeveria merr pjesë si aksionere si dhe në blerje aksionesh të institucioneve financiare.

3.4 MENAXHIMI I BORXHIT TE SHTETIT

Politika e këtij programi konsiston në menaxhimin e borxhit shtetëror dhe raportimin e tij.

3.5 PLANIFIKIMI I BUXHETIT TE SHTETIT

Politika e këtij programi konsiston në rritjen e vazhdueshme të eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike përmes forcimit të lidhjes së buxhetit me politikat prioritare dhe strategjike të Qeverisë si dhe implementimit të procedurave të reja të menaxhimit të investimeve publike, duke kaluar kështu gradualisht nga buxhetimi mbi bazë inpute-sh në buxhetim me bazë performance.

3.6 EKZEKUTIMI I BUXHETIT TE SHETIT (THESARI DHE KONTABILITETI)

Politika e këtij programi konsiston në zbatimin rigoroz të buxhetit të shtetit, raportimin e treguesve të buxhetit e institucioneve buxhetore dhe menaxhimin e liquiditeteve të Qeverisë.

3.7 ADMINISTRIMI I SISTEMIT TATIMOR

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e shërbimeve të një cilësie të lartë ndaj tatimpaguesve, për të bërë të mundur pagimin e detyrimeve tatimore duke shmangur në maksimumin e mundur parregullsitë në pagesën e detyrimeve nga ana e tatimpaguesve.

3.8 ADMINISTRIMI I SISTEMIT DOGANOR

Politika e këtij programi konsiston në përafrimin e standarteve doganore shqiptare me ato të vendeve EU sipas Acquis Communautaire dhe rekomandimet e Organizatës Botërore të Doganave, zbatimin e Programit të Qeverisë dhe plotësimin e detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit.

3.9 AUDITIMI I BRENDSHEM DHE KONTROLLI I FINANCAVE PUBLIKE

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe metodologjisë, si bazë për sigurimin e një procesi auditimi të përgjegjshëm, transparent dhe në përputhje me standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

3.10 PARASHIKIMET MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE

Nëpërmjet këtij programi synohet të kryhen parashikime makroekonomike e fiskale për periudhën afatmesme e vjetore, të kryhen analiza periodike mbi situatën makroekonomike e fiskale, si dhe të formulohen politika të taksave në dobi të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor, me synim arritjen e objektivave makroekonomike dhe fiskale të qeverisë për të siguruar ruajtjen dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit.

3.11 LUFTA KUNDER TRANSAKSIONEVE FINANCIARE JO-LIGJORE

Politika e këtij programi konsiston në marrjen, kërkimin, analizimin dhe shpërndarjen për autoritetet kompetente të informacionit financiar lidhur me të ardhurat që dyshohet se kanë origjinë kriminale dhe financuesit e terrorizmit

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Organizimi i Trajnimeve për stafin e ri në masën 50% dhe për stafin ekzistues në masën 25%.
- Përmirësimi i kushteve të godinës. Krijimin e kushteve sa më të mira të punës për punonjësit e Ministrisë.

4.2 MENAXHIMI I BORXHIT TE SHTETIT

Objektivat e politikës

- Ristrukturimi i drejtorisë së borxhit, modernizimi i sistemeve të informacionit dhe kualifikimi i stafit
- Ulja e raportit të borxhit të brëndshëm me GDP me 0.6%. Huamarrja e brëndshme neto mendohet në nivelin e 2.55% të GDP. Kostoja e borxhit synohet të jetë 3.01% e GDP.
- Përdorimi i variantit 5.3 të programit DMFAS për rregjistrimin e të dhënave të borxhit të jashtëm dhe integrimi i bazës së të dhënave të borxhit të jashtëm dhe të brëndshëm.
- Përdorimi i Rojter-it për lidhjen dhe shkëmbimin e informacionit me Bankën e Shqipërisë. Sigurimi i "Credit Rating" për Shqipërinë.

Produktet që do të ofrohen

- Sigurimi i *Credit Rating*
- Ulja e raportit të borxhit të brëndshëm me GDP në masën 0.6%
- Sigurimi i një huamarrje të brëndshme neto në nivelin 2.55% të GDP
- Niveli i koston së borxhit ndaj GDP të jetë 3.01%

4.3 PLANIFIKIMI I BUXHETIT TE SHTETIT

Objektivat e politikës

- Përgatitja e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2008-2010 duke përfshirë dhe 2 institucione të tjera qëndrore në të.
- Përgatitja e Buxhetit të Shtetit 2008 brënda afateve ligjore
- Hyrja në fuqi e ligjit të ri Organik të Buxhetit.

- Përgatitja dhe miratimi i ligjit të ri Organik të Buxhetit
- Përgatitja dhe shpërndarja e Udhëzimit për hartimin e PBA 2008-2010 dhe buxhetit të vitit 2008
- Përgatitja dhe shpërndarja e Udhëzimit për zbatimin e buxhetit të vitit 2007
- Rishikimi i akteve ligjore dhe nënligjore që kanë efekte në buxhet.

4.4 EKZEKUTIMI I BUXHETIT (THESARI DHE KONTABILITETI)

Objektivat e politikës

- Sigurimi i ekzekutimit të buxhetit dhe vënia në funksionim të plotë e sistemit të kompjuterizuar të thesarit.
- Përgatitja dhe zbatimi i Standarteve të Kontabilitetit dhe Formateve të Raportimit për ekzekutimin e buxhetit për të gjitha degët e thesarit dhe njësitë shpenzuese
- Menaxhimi i likuiditeteve të Qeverisë dhe Llogarisë Unike të Thesarit
- Bashkëpunim me drejtoritë e tjera për formulimin e plotë të ligjit të ri Organik të Buxhetit dhe të udhëzimeve për zbatimin e tij; për VKM mbi financimet e huaja; përgatitja e udhëzimeve të përbashkëta me ministrinë e linjës në lidhje me procesin e decentralizimit dhe operacioneve për celjen e buxhetit

4.5 ADMINISTRIMI I SISTEMIT TATIMOR

Objektivat e politikës

- Realizimi i detyrave në mbledhjen e të ardhurave nga tatimet dhe doganat të programuara në nivelin 174 miliardë lekë.
- Realizimi i të ardhurave tatimore në raport me GDP-ne në nivelin 17.77 %.
- Rritja e numrit të tatimpaguesve të regjistruar me 5 mijë më shumë se viti paraardhës.

Produktet që do të ofrohen

- Të minimizohet kostoja e mbledhjes së të ardhurave tatimore pa rrezikuar efektivitetin e mbledhjes dhe duke ofruar shërbimet e nevojshme për tatimpaguesit.
- Të sigurohen për organet shtetërore të dhëna të sakta statistikore.
- Të propozohet hartimi i politikave të mira tatimore dhe një legjislacion tatimor sa më efektiv, në përputhje me objektivat e qeverisë që kanë të bëjnë me përafrimin e politikave dhe procedurave tatimore shqiptare me ato të Bashkimit Europian ku vendi aspiron të futet.
- Të rekrutohen, trainohen, motivohen dhe mbahet një staf i një cilësie të lartë.
- Të analizohen ankesat e tatimpaguesve, në mënyrë që të përmiresohet cilësia e shërbimit ndaj tatimpaguesve.
- Të sigurohet forcimi i kontrollit tatimor dhe ulja e shkallës së evazionit fiskal.

4.6 ADMINISTRIMI I SISTEMIT DOGANOR

Objektivat e politikës

- Rritja e vjeljes së të ardhurave doganore për buxhetin e shtetit.
- Forcimi gjithnjë e më tepër i rolit ekonomik të doganës me qëllim zhvillimin e ekonomisë, garantimin e një konkurrence të lirë e të barabartë në treg duke u aktivizuar gjithnjë e më shumë në mbrojtjen e markave, patentave, të pronësisë intelektuale etj.
- Forcimi i misionit mbrojtës të doganës që konsiston në garantimin e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e konsumatorit në luftën kundër trafikut të drogës e substancave të tjera psikotrope, në mbrojtjen e mjedisit, faunës e florës, në mbrojtjen e moralit publik.
- Doganat do të luajnë rolin e një institucioni koordinues, përgjegjës për kontrollin e mallrave që kalojnë përmes kufijve të jashtëm të Shqipërisë, në kuadrin e sistemit të integruar të mbrojtjes së kufijve të Republikës së Shqipërisë.
- Rritja e efikasitetit të pjesëmarrjes së shërbimit doganor në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufijve në bashkëpunim me axhensitë e tjera që operojnë në zonat e tjera doganore kufitare.

Produktet që do të ofrohen

- Mbledhja e të ardhurave të parashikuara për vitin 2007 në nivelin rreth 85 Miliard lekë
- Rritja me rreth 5-10% të nivelit të çdoganimit të mallrave kryesore me ngarkesë të lartë fiskale që janë objekt i mosdeklarimit si cigare, kafe, pije alkoolike.
- Zbatimi i masave për ruajtjen e sigurisë së tregtisë ndërkombëtare dhe për parandalimin e akteve terroriste dhe krimet të organizuar.
- Përsosja e sistemit të kompjuterizuar të metodikës së kontrolleve, bazuar në menaxhimin e risikut, shkëmbim informacioni *on line* me strukturat ndërkombëtare të specializuara.
- Kontrolli i lëvizjes së mallrave me metodologji (mjete kontrolli dhe aparatura) moderne të përdorura në vendet e BE-së, për ekzaminimin e mallrave dhe të mjeteve transportuese; trajnimi i stafit për përdorimin me efikasitet të tyre
- Përmirësimi rrënjësor i infrastrukturës së Degës Doganore Tiranë duke bërë investimet e nevojshme për këtë qëllim. Investime në Degën Doganore Murriqan.
- Upgrade i sistemit të kompjuterizuar Asycuda ++ në versionin Asycuda World duke siguruar një rritje të cilësisë së shërbimit në kuadrin e plotësimit të kërkesave për uljen e barrierave për biznesin.

4.7 AUDITIMI I BRENDSHEM DHE KONTROLLI I FINANCAVE PUBLIKE

Objektivat e politikës

- Ristrukturimi dhe riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm si struktura përgjegjëse për udhëheqjen, menaxhimin dhe koordinimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.
- Kryerja e misioneve të Auditimit në institucione publike për të siguruar përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të fondeve publike.

Plani i Integruar i Ministrisë

- Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor e procedural për Auditimin e Brendshëm, rishikimi i Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm dhe Rishikimi i Ligjit për Auditimin e Brendshëm.
- Sipas matricave përkatëse, janë përcaktuar si objektiva edhe propozimet për përmirësime në aktet nënligjore që lidhen me kontrollin tatimor dhe marrëdhëniet e ndërsjellta me auditimin e brëndshëm.
- Kryerja e misioneve të mbikqyrjes së auditimit të brëndshëm të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm dhe forcimin e rolit të audituesve të brëndshëm në institucionet e Sektorit Publik.
- Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimi i burimeve njerëzore.
- Hartimi i manualit të procedurave për Kontrollin e Manaxhimit Financiar.

Produktet që do të ofrohen

- Ligji për Auditimin e Brëndshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Metodika e Auditimit Financiar e miratuar.
- 150 Auditues të certifikuar.
- Auditimi i katërmbëdhjete degëve të thesarit në rrethe, për procedurat e punës, ligjshmërinë e financimit të shpenzimeve të institucioneve dhe përdorimin e vet buxhetit të tyre.
- Auditimi i Degëve tatimore Korçë dhe Dibër për programimin e detyrave në mbledhjen e të ardhurave tatimore, zbatimin e legjislacionit tatimor, për kontrollin tatimor dhe për përdorimin e fondeve të veta.
- Auditimi i Degëve doganore Kakavijë dhe Vlorë për zbatimin e legjislacionit në vjeljen e taksave doganore dhe tatimeve të tjera që realizohen gjatë zhdoganimit, zbatimin e tarifave dhe referncave doganore, evidentimin dhe mbylljen e tranziteve të mallrave, si dhe përdorimin e fondeve të veta.
- Auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse në Ministrinë e Financave, lidhur me zbatimin e procedurave në rekrutimin e punonjësve dhe administrimin e dokumentacionit përkatës, ligjshmërinë e pagesave të kryera për shpenzimet e ndryshme operative të Ministrisë dhe për investimet e kryera.
- Mbikqyrja e dy njësive të auditimit në institucionet vartëse për funksionimin e tyre dhe zbatimin e kërkesave të ligjit dhe të Manualit të auditimit të brëndshëm në sektorin publik.

4.8 PARASHIKIMET MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE

Objektivat e politikës

- Parashikimet e kuadrit makro për PBA 2008-2010.
- Parashikime periodike të vitit 2007.
- Përgatitja e notës teknike të kuadrit makroekonomik, pjesë e PBA.
- Analiza periodike e situatës makroekonomike dhe fiskale.

- Përgatitja e paketës fiskale për vitin 2008.
- Hartimi i një kuadri makroekonomik konsistencë, përmes bashkëpunimit dhe marrëveshjeve me Bankën e Shqipërisë, për të siguruar që politika fiskale të hartohet në përputhje me politikën monetare.

4.9 LUFTA KUNDER TRANSAKSIONEVE FINANCIARE JO-LIGJORE

Objektivat e politikës

- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional në vend dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Rritja e numrit të raporteve të analizuara dhe përpunuara, duke ofruar në shumë evidenca e indikacione për të ndihmuar procedimet penale për këtë qëllim.
- Rritja e numrit të inspektimeve dhe njohja e subjekteve me detyrimet ligjore me qëllim rritjen e raportimit të RTV e RAD .
- Shtrirja e programit AML në 17 banka të nivelit të dytë.
- Përmirësimi i legjislacionit dhe i akteve nënligjore për luftën kundër krimit të organizuar.
- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit “ Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”.

Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subveçione t 603	Të tjera transferte korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	74.2	100	0	0	0	35	209.2
Parashikimet makroekonomike dhe fiskale	14.5	0	0	0	0	0	14.5
Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	0	0	0	45	120	0	165
Mbështetje dhe pjesëmarrje në institucionet financiare	0	0	0	85	0	0	85
Planifikimi i buxhetit të Shtetit	24.2	0	0	0	0	0	24.2
Ekzekutimi i buxhetit të Shtetit	170.2	45	0	0	0	0	215.2
Menaxhimi i borxhit të Shtetit	7.3	0	0	0	0	0	7.3
Auditimi i brëndshëm dhe kontrolli i financave publike	23.6	25	0	0	0	0	48.6
Total	314	170	0	130	120	35	769
Administrimi i sistemit tatimor	880	245	0	10	0	120	1,255
Administrimi i sistemit doganor	1,200	296.9	0	1.1	0	100	1,598

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi		
Stafi i ri i trajnuar	%	50
Stafi ekzistues i trajnuar	%	25
Planifikimi i buxhetit të shtetit		
Mbledhja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat	Mld lek	174
Realizimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat (% e PBB)	%	17.77
Menaxhimi i borxhit të shtetit		
Raporti i borxhit të brendshëm me PBB i ulur	%	0.6
Huamarrja e brendshme neto (% e PBB)	%	2.55
Kostoja e borxhit (% e PBB)	%	3.01
Auditimi i brendshëm dhe kontrolli i financave publike		
Auditime të kryera në deget e thesarit, të tatimeve dhe doganave në rrethe	Nr	18
Auditim në drejtorinë e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse në Ministrinë e Financave	Nr	1
Auditime në njësi të auditimit në institucione vartese	Nr	2
Auditues të certifikuar	Nr	150
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve		
Numri i tatimpaguesve të regjistruar i rritur	Nr	5,000
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave		
Të ardhurat tatimore të mbledhura nga doganat	Mld lek	85
Rritja e cdoganimit të mallrave të forta	%	5-10
Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave		
Shtrirja e programit AML në banka të nivelit të dytë	Nr	17

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

Akte ligjore dhe nënligjore për t'u paraqitur gjatë 2007	Afati
<p>Projektligji për Ligjin e Ri Organik të Buxhetit</p> <p>Projektligji për buxhetin vjetor 2008</p> <p>Projektligjet për paketën fiskale 2008</p> <p>Projektligj dhe udhëzimi përkatës i Ministrit të Financave "Për Tatimin mbi të Ardhurat</p> <p>Projektligj dhe udhëzimi përkatës I Ministrit të Financave "Për Procedurat Tatimore"</p> <p>Projektligji dhe udhëzimi përkatës "Për TVSH"</p> <p>Projektligji për Taksat Portuale (në ndryshim të ligjit 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave nacionale në Republikën e Shqipërisë")</p> <p>Projektvendimi për Numrin e Punonjësve</p> <p>Projektvendimet lidhur me përdorimin e Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave dhe Kontigjencës.</p> <p>Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave"</p>	
Iniciativat ligjore në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bashkimin Europian	
Projektligj dhe Udhëzimi përkatës i Ministrit të Financave "Për Akcizat", për përafrimin e nivelit të akcizave me vendet e BE-së	Qershor 2007
Projektvendimet për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor, në përputhje me Rregulloret 31988R3915 dhe 31991R3357	Mars 2007
Projektligjet për ndryshime në Kodin Doganor, në përputhje me 918/83/EEC e menduar nga Rregullorja 3691/87 EEC ; 31992R2913 dhe rregulloren 31992R2913	Qershor 2007
Projektvendimet për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor (aneksi IV), në përputhje me Rregulloren EC 1602-2000 (Aneksi XV)	Qershor 2007
Projektligji për ndryshimin e Kodit Doganor, pjesa VIII	Mars 2007
Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 9258, datë 17.05.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"	Dhjetor 2007
Hartimi dhe miratimi I VKM për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kualifikimin e Punonjësve të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik	Mars 2007
Hartimi dhe miratimi I VKM "Për disa ndryshime në manualin e procedurave të auditit të brëndshëm"	Mars 2007
Hartimi dhe miratimi I VKM "Për përditësimin e Letër Politikave dhe Planit të Veprimit për KBFP	Qershor 2007
Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin 9009, datë 13.2.2003 Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik"	Mars 2007
Miratimi i Manualit për Shpenzimet Publike	Korrik 2007
Hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për rregullimin e profesioneve"	Qershor 2007
Hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për kontabilitetin publik"	Qershor 2007
Miratimi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar	Qer. 07-Jan. 08
Amendimi i ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"	Qer. 06-Jan. 08
Hartimi dhe miratimi I VKM-se për Standartet Kombëtare të Kontabilitetit	Dhj. 06-Jan. 08

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Programin e Qeverisë

Reduktimi i peshës së ekonomisë informale

Politikat në sektorin e financave publike janë të lidhura ngushtë me arritjen e këtij objekti të qeverisë. Për këtë:

- Politika e taksave dhe administrimi i sistemit tatimor do të synojnë rritjen e nivelit të shlyerjes vullnetare të detyrimeve nga taksapaguesit dhe formalizimin e punësimit
- Forcimi i disiplinës fiskale, zbatimi i plotë i dispozitave të legjislacionit tatimor dhe doganor, lufta kundër korrupsionit brenda agjencive të të ardhurave, trafikeve dhe pastrimit të parave do të sjellin gjithashtu efekte në reduktimin e ndjeshëm të asaj pjese të ekonomisë informale dhe kriminale

Shqipëria vend atraktiv për investimet e huaja

- Politika e taksave do të synojë përmirësimin e klimës së investimeve. Barra e taksave nuk do të deformojë vendimet e investitorëve vendas dhe të huaj për të investuar në Shqipëri.

Garantimi i stabilitetit makroekonomik

- Ulja e deficitit buxhetor nëpërmjet rritjes së të ardhurave dhe rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve publike.
- Përdorimi i borxhit për mbulimin e nevojave për investime publike
- Ulja e shpenzimeve të huamarrjes si rezultat i uljes së deficitit në përqindje të PBB-së
- Investimet publike dhe private në fund të periudhës katërvjeçare (2009) do të arrijnë në nivelin 30% të PBB-së. Investimet publike me financim të brendshëm do të arrijnë në nivelin e 5% të PBB-së.
- Stabilizimi në mënyrë graduale i bilanceve primare dhe korente për të siguruar mbulimin e shpenzimeve për interesa dhe për rritjen e financimit të investimeve publike nga të ardhurat fiskale të qëndrueshme

Politikat dhe administrimi fiskal

Angazhimet e programit të qeverisë dhe outputet përkatëse të politikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:

Angazhimi:

- Thjeshtimi dhe qartësimi i procedurave tatimore, përshtetimi i shërbimeve ndaj taksapaguesve nëpërmjet IT-se, zgjerimi i përfshirjes së sistemit bankar. Forcimi i kapaciteteve njerëzore në administratat tatimore dhe doganore

Output:

- Procedura të rishikuara me përmirësimet e nevojshme; përmirësim i website të DPT-së me synim objektivin e e-government

Angazhimi:

Plani i Integruar i Ministrisë

- Vendosja e rregullave transparente në rekrutimin, ngritjen në detyrë e shkarkimin e punonjësve në përputhje me rregullat bazë të Shërbimit Civil, Kodit Doganor dhe Ligjit për Administrimin dhe Procedurat Tatimore

Output:

- Shprehja dhe aplikimi në mënyrë të qartë i rregullave të sipërpërmendura.

Angazhimi:

- Ngritja e instancave apeluese për të garantuar mbrojtjen e tatimpaguesve në dy nivele: një brënda shërbimit të të hyrave dhe një tjetër të pavarur nga ekzekutivi shqiptar, në formën e një Tribunali Tatimor, si shkallë e fundit e ankimimit administrativ

Output:

- Ndërmarrja e hapave për finalizimin e instancës së Tribunalit Tatimor dhe përmirësimi i punës në drejtorinë e apëlimit

Angazhimi:

- Futja e vetëdeklarimit për cdo tatim të vecantë

Output:

- Përgatitja e formateve të thjeshte dhe të kuptueshëm për llojet e ndryshme të taksave

Angazhimi:

- Aplikimi në praktikë i të gjitha marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe për shkëmbimin e informacionit në luftë kundër evazionit me vendet fqinjë

Output:

- Shkëmbimi i informacioneve me vendet fqinjë dhe eliminimi i taksimit të dyfishtë

Angazhimi:

- Edukimi fiskal i publikut; përgatitja dhe lancimi i programeve edukative, prodhimi i guidave dhe i materialeve të tjera informative; informimi i gjërë i bizneseve dhe qytetarëve mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore

Output:

- Prodhimi i guidave për qytetare dhe biznese

Angazhimi:

- Rishikimi i gjithë sistemit tatimor duke synuar një taksim sa me uniform të pasurisë, të të ardhurave dhe konsumit

Output:

- Përgatitja e raporteve

Angazhimi dhe output-i përkatës në lidhje me politikën e taksave:

- Reduktimi gradual i taksave dhe shkallëve tatimore. Ulja e nivelit të tatim fitimit në 19% në vitin 2007. Ulja e numrit të shkallëve të tatimit mbi të ardhurat personale dhe të shkallës maksimale tatimore. Ulja progresive e taksave doganore në kuadrin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i MTL–ve dhe anëtarësimi në OBT.

Buxheti bazuar në prioritete. Transparenca dhe pjesëmarrja. Administrimi i shpenzimeve publike

- Reformimi i sistemit të planifikimit të financave publike nëpërmjet zbatimit të Sistemit të Integruar të Planifikimit
- Rritja e qëndrueshme e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe të funksionimit të shërbimeve direkte publike
- Krijimi i një sistemi eficient të menaxhimit financiar, kontrollit, raportimit dhe auditimit të shpenzimeve publike.
- Përgatitja e buxhetit brënda afateve ligjore, e plotësuar me analiza makroekonomike të objektivave fiskale, të qëndrueshmërisë buxhetore e fiskale. Rritja e transparencës së procesit të buxhetimit.

Aneks 3 Rezultate që lidhen me Integrimin European

Sipas renditjes që është bërë në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bashkimin European, më poshtë janë përmendur rezultatet që lidhen me Integrimin European, sipas programeve të ndryshme buxhetore.

Lufta kundër korrupsionit

Programi buxhetor: “Administrimi i Sistemit Doganor”

- Menaxhimi korrekt i quoteve të MTL-ve përmes shtrirjes së sistemit ASYCUDA ++ në gjithë vëndin
- Unifikimi i procedurave për zbatimin korrekt të ligjit për konfliktin e interesave dhe standarteve të duhura për identifikimin, deklarimin, regjistrimin.

Programi buxhetor: “Administrimi i Sistemit Tatimor”

- Aplikimi i sistemit të inteligjencës dhe përdorimi efikas i tij me të dhënat e rrjetit të zgjeruar kompjuterik, nëpërmjet përmirësimit të SIT dhe përdorimit të gjërë të tij
- Azhornimi i manualeve proçeduriale të regjistrimit, masave shtrënguese dhe akcizës
- Dokumentimi dhe përmirësimi i proçedurave të punës së Policisë Tatimore
- Zbatimi i programit të zgjedhjes së kompjuterizuar të tatimpaguesve për kontroll

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë

Programi buxhetor: “Administrimi i Sistemit Doganor”

- Analiza e të dhënave të import/eksportit të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe organizimi i Komiteteve të Përbashkëta me palët nënshkruese të MTL-ve për monitorimin e zbatimit të MTL-ve
- Zhvillimi i negociatave për konkludimin e MTL-së Shqipëri - Turqi
- Zhvillimi i raundeve simultane të negociatave për konkludimin e MTL-së unike Zgjerimi/Amendimi i CEFTAS.

Tatimet

Programi buxhetor: “Administrimi i Sistemit Tatimor”

- Diagnostikimi, dokumentimi dhe përmirësimi i proçedurave të kontrollit dhe investigimit të Tatimpaguesve; trajnimi i stafit
- Dokumentimi dhe përmirësimi i proçedurave të kontrollit të brendshëm dhe investigimit të brendshëm; trajnimi i stafit
- Hartimi i një rregulloreje për Drejtorinë e Apelimeve
- Zgjerimi i sistemit të kompjuterizuar tatimor në disa rrethe

Plani i Integruar i Ministrisë

- Ngritja e qëndrës së përhershme të Trajnimit Tatimor (gjetja e fondeve)
- Zhvillimi i programit të administrimit të kompjuterizuar të të dhënave të personelit në funksionim

Doganat

Programi buxhetor: “Administrimi i Sistemit Doganor”

- Hartimi i Planit Vjetor të trajnimit të personelit doganor
- Implementimi i Planit Vjetor të Trajnimeve
- Shtrirja e programit ASYCUDA ++ në gjithë vëndin
- Menaxhimi i vlerës doganore dhe cmimeve të referencës. Implementimi uniform i tyre në gjithë territorin doganor. Shtrirja e modulit VALU-NET

Parandalimi i pastrimit te parave

Programi buxhetor: “Lufta kundër Transaksioneve Financiare jo Ligjore”

- Krijimi dhe funksionimi i një grupi pune për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit 9258 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”
- Trajnimi i zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave

Financat publike dhe Auditimi i Brendshëm

Programi buxhetor: “Auditimi i Brendshëm dhe Kontrolli i Financave Publike”

- Krijimi Grupit të Punës për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP) dhe trainimi stafit të KBFP

Planifikimi buxhetor

Programi buxhetor: “Planifikimi i Buxhetit të Shtetit”

- Ngritja e Grupit të Punës për përgatitjen e Manualit të Shpenzimeve Publike
- Përgatitja e PBA dhe buxhetit vjetor

Kontabiliteti Publik

Programi buxhetor: “Ekzekutimi i Buxhetit”

- Organizmi i tryezave të rrumbullakta për projektligjin mbi rregullimin e profesioneve
- Përgatitja e software për menaxhimin e inventareve të njëjësive shpenzuese
- Trajnime të përfaqësuesve të sektorit publik mbi standartet ndërkombëtare
- Trajnimi I kontabilistëve

Aneks 4 Rezultate që lidhen me anëtarësimin në NATO

Ministria e Financave është pjesë e grupit negociator për antarësimin në NATO. Kontributi i MOF në këtë proces është i lidhur me:

- Pjesëmarrjen në përgatitjen e dokumentit të anëtarësimit (MAP) dhe mbrojtjen e tij në kuadrin e grupeve të punës në Bruksel dhe Tiranë.
- Parashikimin e taveve sektoriale në PBA, në përputhje me objektivat e Qeverisë për anëtarësim. Realizimi i objektivit për buxhetin e mbrojtjes 2% e PBB-së brenda vitit 2008.
- Ndjekjen e të gjitha delegacioneve të NATO-s dhe paraqitjen e çështjeve që lidhen me detyrimet e MOF: situata ekonomike dhe financiare e shtetit.
- Realizimin e detyrimeve lidhur me informacionin e klasifikuar.

Aneks 5 Investimet publike¹

Administrim, menaxhim, planifikim

	000/lekë
Rikonstruksion i godinës së Ministrisë së Financave	11,000
Rikonstruksion i godinave të degëve të thesarit në rrethe	1,000
Përshtatje e bodrumit të Ministrisë së Financave	5,000
Sistemi i kondicionimit të Ministrisë së Financave	10,000
Pajisje zyresh Ministria e Financave	8,000

Administrimi i sistemit tatimor

	000/lekë
Transferimi i DPT në ambiente të tjera-(ish materniteti), restaurimi i ndërtesës, pajisje zyresh	20,000
Transferimi i degës së tatimeve Tiranë (restaurim dhe pajisje)	72,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Delvinë	2,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Lushnje	2,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Durrës	4,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Elbasan	3,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Korçë	2,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Shkodër	3,000
Rikonstruksion ndërtesë në Degën e Tatimeve Vlorë	1,000
Blerje automjesh	25,000
Blerje pajisjesh për sigurimin e energjisë elektrike	10,000

Administrimi i sistemit doganor

	000/lekë
Rikonstruksion i godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave	28,000
Ndërtimi i kompleksit doganor Bilatë	21,000
Blerje makineri dhe pajisje	21,000

¹ Me financim të brendshëm

Aneks 6 Projekte të ndihmës së huaj

Donatori	Projekti	Fusha e politikës	Shuma totale, mln Eur	Kohëzgjatja/St atusi
Hollandë, Suedi, UK	"Forcimi i Menaxhimit të Shpenzimeve Publike"	Përmirësimi i shpenzimeve publike/Planifikimi i buxhetit	5.9	2006-2008
EU-Albania CAFAO	"Mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të RSH"	Zbatimi i detyrave sipas planit strategjik të Doganës Shqiptare për periudhën 2007-2013	3.0	Aplikuar në dhjetor 2006
CARDS (fqinjësia Shqiperi-Greqi)	"Ngritja e një pike të re të kalimit të kufirit në Qafë Botë, Konispol"	Nxjtja e bashkëpunimit dhe tregtisë me Greqinë	2.3 (25% financim lokal)	Aplikuar në tetor 2006
CARDS 2004-PAMECA	"Ngritja e pikës së përbashkët të kalimit të kufirit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, Murriqan, Shkodër"	Nxjtja e një bashkëpunimi më të frytshëm midis dy vëndeve	1.6	Marrëveshja gati për nënshkrim
Qeveria Italiane	"Mezzogiorno-Zona e Ballkanit"	Përmirësimi i procedurave doganore në kufijtë kombëtare përgjatë seksionit të rrugës së Korridorit VIII	0.3	Marrëveshja po negociohet
UNCTAD	"Zhvillimi i sistemit të integruar të informatizimit në Doganë, bazuar në programin ASYCUDA"	Vazhdimësi në asistencën teknike për sistemin ASYDUDA, asistencë teknike dhe strategjike, mbështetje dhe trajnim në përputhje me standartet evropiane dhe praktikën më të mirë	Nuk ka të dhëna	Marrëveshja po negociohet
BE-Albania CAFAO	"Tatime dhe Dogana"	Administrimi i sistemit tatimor	Nuk ka të dhëna	2005-2008
SIDA-Qeveria Suedeze	"Tatime dhe Dogana"	Administrimi i sistemit tatimor	Nuk ka të dhëna	2007
CARDS 2005	"Përmirësimi i zyrave në rrethet e Ministrisë së Financave"	Përmirësimi i shpenzimeve publike/Ekzekutimi i buxhetit	1.0	2006-2007
SHBA-USAID	"Programi për përmirësimin e kërkesave për pjesëmarrje në Millenium Challenge Account"	Administrimi i sistemit tatimor	Mln\$ 5.44	2006-2008
INWENT-Qeveria Gjermane	Tatime dhe Dogana	Administrimi i sistemit tatimor	Nuk ka të dhëna	2007?

